



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

---

Numri i lëndës: 2022:126374

Datë: 30.05.2024

Numri i dokumentit: 05756530

P.nr.501/22

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtari vetëm gjykuese Leon Përlaska, me pjesëmarrjen bashkëpunëtores profesionale Teuta Spahija, në çështjen penale kundër të pandehurve M. G.dhe A. G., për shkak të veprës penale të kryer në bashkëkryerje Uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 320 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.688/22 të datës 15.06.2022, në bazë të nenit 229 par.5, 357 të KPPRK-së dhe nenit 12 dhe 15 të Ligjit për Ndërmjetësim nr.06/L-009, jashtë shqyrtimit, me datë 30.05.2024, bie këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET marrëveshja për ndërmjetësim me shenjën ND.nr. 838/24 e lidhur me datë 29.05.2024 në mes të pandehurve (pala A) M. G.nga Peja, ku edhe banon në Rr. “....” Hyrja B-kati 4-të banesa nr.12, me numër personal .....dhe i pandehuri A. G. nga fsh.C. i Ulët K. Deçan me vendbanim në Pejë në Rr. “....” Hyrja B-kati 4-të banesa nr.12, me numër personal .... dhe të dëmtuarit (pala B) D. V.nga Peja “...” nr... dhe I dëmtuari L. G.nga Peja “.....” nr....
- II. HEDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.688/22 të datës 15.06.2022.
- III. PUSHOHET procedura penale ndaj të pandehurve M. G.nga Peja, ku edhe banon në Rr. “....” Hyrja B-kati 4-të banesa nr.12, me numër personal .... dhe i pandehuri A. G. nga fsh.C. i Ulët K. Deçan me vendbanim në Pejë në Rr. “....” Hyrja B-kati 4-të

banesa nr.12, me numër personal .... për shkak të veprës penale të kryer në bashkëkryerje Uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 320 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, për arsye se të pandehurit dhe të dëmtuarit, kanë arritur marrëveshje për ndërmjetësim.

IV. Shpenzimet e procedurës penale i bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

#### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm ka parashtruar aktakuzën, PP.II.nr.688/22 të datës 15.06.2022, kundër të pandehurve M. G.dhe A. G., për shkak të veprës penale të kryer në bashkëkryerje Uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 320 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Në këtë çështje penale, kjo gjykatë me datë 28.05.2024, ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar ne te cilën kane qenë të pranishëm prokurorja e shtetit Arlinda Nallbani-Gacaferi, të pandehurit M. G.dhe A. G. me mbrojtësin av. Gëzim Kollçaku, e dëmtuara D. V. me përfaqësuese të autorizuar Fatmir Kurmehaj, mirëpo në këtë seancë sipas autorizimit zëvendësues prezanton av. Njomza Hoxha.

Mbrojtësi para leximit të aktakuzës gjykatës i ka kërkuar që lënda të shkon në procedurën e ndërmjetësimit, me ç ‘rast palët njëzëri janë deklaruar se pajtohen që çështja penale të referohet në procedurën e ndërmjetësimit, me qëllim të arritjes së marrëveshjes eventuale.

Pas pëlqimit të palëve për zgjidhjen e kësaj çështje penale në procedurën e ndërmjetësimit, gjyqtari i çështjes e ka ndërprerë seancën dhe me datë 28.05.2024, ka marr vendimin për ta dërguar lëndën pranë koordinatorit për ndërmjetësim të kësaj gjykate që të procedoj lëndën në procedurë të ndërmjetësimit.

Me datë 29.05.2024, në Qendrën e Ndërmjetësimit në Pejë, është lidhur marrëveshja për zgjidhjen e ndërmjetësuar nga ndërmjetësuesi Leonita Lajqi Muçaj, ndërmjet të pandehurve (pala A) M. G.nga Peja, ku edhe banon në Rr. “....” Hyrja B-kati 4-të banesa nr..., me numër personal ... dhe i pandehuri A. G. nga fsh....i U. K. Deçan me vendbanim në Pejë në Rr. “....” Hyrja B-kati .-të banesa nr..., me numër personal .... të cilin e përfaqëson av.Gëzim Kollçaku dhe të

dëmtuarit (pala B) D. V. nga Peja “.....” nr... të cilën e përfaqëson av.Fatmir Kurmehaj dhe I dëmtuari L.G. nga Peja “.....” nr....

Gjatë marrëveshjes përfaqësuesi i palës (A) ka deklaruar se banesa në fjalë është blerë në vitin 2001 me kontratë mbi shitblerje nga ish pronari Z. M., e cila banesë është blerë nga ana e A. G. prindi i L. G.. Me datën 14.08.2008 është lidhur kontrata mbi dhuratën në mes të dhuratëdhënies A. G. dhe L. G. djali si dhuratë marrës. Pas martesës së L. me D.me datën 12.10.2021 kjo banesë ju është dhuruar bashkëshortes së tij D. V. në bazë të kontratës mbi dhuratën, e në ndërkohe kanë lindur disa mosmarrëveshje që me ç ‘rast ka ardhur tek aktakuza për lirim e banesës e ku në të njëjtën kohë ka pasur edhe një padi në çështjen civile për revokimin e kontratës mbi dhuratën dhe vërtetimin e të drejtës në pronësi e iniciuar nga ana e A. G. kundër L.G..

Sipas marrëveshjes së arritur ndërmjet të pandehurve dhe të dëmtarëve palët kanë deklaruar se marrëveshjen e lidhin në vullnet të plotë dhe pa shtytje nga askush.

Meqenëse ekziston pëlqimi i dyanshëm që këto mosmarrëveshje, kërkojnë të zgjidhen përmes ndërmjetësuesit me këto kushte si në vijim:

1. Pala e dëmtuar D. V. dhe L. G. obligohen që A. G. dhe M. G. që ti lejohet në shfrytëzimin e qetë dhe të pa penguar nga askush dhe L. G. dhe D V. lidhur me banesën në fjalë deri sa të njëjtit të jenë gjallë.
2. Po ashtu banesën në fjalë të mos i ipet me qera apo të mos shitet derisa të njëjtit të jenë gjallë.
3. Obligohet A. G. si palë paditëse të tërheq padinë C.nr.../22 për revokimin e kontratës mbi dhuratën dhe vërtetimin e pronësisë nga momenti i nënshkrimit të kësaj marrëveshje.

Palët pa ndonjë kërcënim dhe me vet dëshirë kanë shprehur gatishmëri që kjo çështje të zgjidhet me marrëveshje në procedurën e ndërmjetësimit dhe nuk i kontestojnë asnjë nga pikat e lartpërmendura.

Qendra e Ndërmjetësimit me datë 29.05.2024, me numër të lëndës në ndërmjetësim Nd.838/24 ka lidhur marrëveshjen e palëve të lartpërmendura për zgjidhjen e ndërmjetësuar.

Andaj, gjykata duke vepruar sipas dispozitave të nenit 229 paragrafi 5 të KPPRK-së, dhe nenit 15 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-009 për Ndërmjetësim, e aprovoi këtë marrëveshje pasi që e njëjta u vlerësua se është lidhur me vullnetin e plotë të palëve dhe është në pajtim me dispozitat e KPPRK-së dhe me Ligjin për Ndërmjetësim, ku kjo marrëveshje do ta ketë fuqinë e titullit ekzekutiv.

Në bazë të nenit 453 paragrafi 1 të KPPRK-së, shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Gjykata duke u bazuar në provat si më lartë dhe në bazë të nenit 229 par.5 , 357 par.1 nën par. 1.3, nenit 453 të KPPRK-së dhe nenit 12 dhe 15 par.1 të Ligjit për ndërmjetësim, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE PEJË**  
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal  
P.nr.501/22, më datë 30.05.2024

Bashkëpunëtorja Profesionale:  
Teuta Spahija

Gjyqtari i vetëm gjykues:  
Leon Përlaska

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij  
Aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat  
prej 3 ditësh, Gjykatës së Apelit në Prishtinë,  
nëpërmes kësaj Gjykate.